



Korniza për rihapjen e shkollave

Prill 2020

Mbyllja e shkollave në mbarë botën për shkak të pandemisë së COVID-19 ka krijuar një rrezik të paprecedent ndaj arsimit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres, iu bëri thirrje së fundmi qeverive dhe donatorëve që t'i japin përparësi arsimit për të gjithë fëmijët, duke përfshirë ata më të marginalizuarit, ndërkaq është ngritur Koalicioni Global për Arsimin me qëllim mbështetjen e qeverive për të përmirësuar mësimin në distancë dhe për të lehtësuar rihapjen e shkollave.

Megjithëse ende nuk kemi prova të mjaftueshme për të vlerësuar efektin e mbylljes së shkollave ndaj rrezikut të përhapjes së sëmundjes, efektet negative të mbylljes së shkollave për sigurinë, mirëqenien dhe të nxënit të fëmijëve janë të mirëdokumentuara. Gjithashtu, ndërprerja e shërbimeve arsimore ka pasojë serioze dhe afatgjata për ekonominë dhe shoqëritë, të tilla si rritja e pabarazisë, problemet shëndetësore dhe përkeqësimi i kohezionit social. Në shumë vende, të dhënat mbi prevalencën e virusit janë të paplota dhe vendimmarrësve do t'u duhet të kryejnë vlerësimet e tyre në një situatë me informacione të paplotë dhe një gjendje pasigurie. Paralelisht, qeveritë kombëtare dhe partnerët duhet që të punojnë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën e çdo fëmije për t'u arsimuar, për të qenë i shëndetshëm dhe i sigurt, siç parashikon Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të ketë rëndësi parësore.


Udhëheqësit e vendeve të ndryshme po përballen me kompromise të vështira dhe të paqarta, teksa iu duhet të konsiderojnë lehtësimin e masave të marra. Kjo kornizë shërben për të ndihmuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me rihapjen e shkollave, për të mbështetur masat përgatitore kombëtare dhe për të drejtuar procesin e zbatimit të tyre, si pjesë e proceseve të përgjithshme të planifikimit mbi shëndetin publik dhe arsimin. Kontekstualizimi dhe përshtatja e vazhdueshme janë të domosdoshme në mënyrë që të mund të reagojë në përputhje me kushtet vendase dhe të përmbushen nevojat e të nxënit, shëndetit dhe sigurisë së çdo fëmije.

Përse duhet të rihapen shkollat?

Shkëputja nga e orët mësimore në klasë mund të ketë ndikime serioze në aftësinë e fëmijëve për të nxënë. Sa më gjatë që fëmijët e marginalizuar nuk e ndjekin mësimin në shkollë, aq më e ulët është mundësia që ata të rikthehen. Gjasat që fëmijët nga familjet shumë të varfra të mos ndjekin shkollën fillore janë thuajse pesë herë më të larta se ato për fëmijët nga familjet më të pasura. Mosndjekja e mësimin në shkollë rrit gjithashtu gjasat për shtatzëni në adoleshencë, për shfrytëzim seksual, për martesë në moshë të mitur, për dhunë dhe rreziqe të tjera. Gjithashtu, mbyllja e shkollës për kohë të gjatë prek dhe ofrimin e shërbimeve thelbësore që lidhen me të, të tilla si imunizimi, ushqyerja në shkollë, dhe mbështetja për shëndetin mendor dhe atë psikosocial, si dhe mund të shkaktojë stres dhe ankth për shkak të shkëputjes nga moshatarët dhe ndryshimet rrënjësore të rutinës. Këto ndikime negative janë shumë herë më serioze për fëmijët e marginalizuar, si ata që jetojnë në vende të prekura nga konflikti dhe kriza të tjera të tejzgjatura, për migrantët, fëmijët e shpërngulur me forcë, minoritetet, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e institucionalizuar. Rihapja e shkollës duhet të kryhet në mënyrë të sigurt dhe të bazohet në reagimin e përgjithshëm shëndetësor të secilit vend ndaj COVID-19, si dhe të ndërmerren të gjitha masat e arsyeshme për mbrojtjen e nxënësve, stafit, mësuesve dhe familjeve të tyre.

Kur, ku dhe cilat shkolla duhet të rihapen?

Përcaktimi i kohës së rihapjes së shkollave duhet të mbështetet në interesin më të lartë të fëmijëve duke marrë parasysh shëndetin e përgjithshëm publik, bazuar në një vlerësim të përfitimeve dhe rreziqeve përkatëse dhe duke u mbështetur në prova ndërsektoriale dhe specifike për kontekstin, duke përfshirë arsimin, shëndetin publik dhe faktorët socio-ekonomikë. Një analizë e tillë do të ndihmojë gjithashtu për t'u dhënë prioritet masave për lehtësimin e rrezikut. Vendimmarrja duhet të kryhet bashkërisht me palët vendore të interesit, në mënyrë që veprimet e ndërmarrja të bazohen në analizën përkatëse të secilit kontekst vendor.



Vendimet për rihapjen e shkollave kërkojnë që vendet të grumbullojnë me shpejtësi informacion kyç mbi mënyrën se si shkollat, mësuesit, nxënësit dhe komunitetet po përballen me mbylljen e shkollave dhe me pandeminë. Anketat e shpejta me drejtuesit e shkollave dhe ata vendorë, mësuesit, nxënësit dhe prindërit mund të ndihmojnë për të siguruar këtë informacion. Më pas, vendimmarrësit duhet të vlerësojnë se si **mund të mbështesin më së miri të nxënësit dhe mirëqenien në secilin kontekst**, duke u kushtuar vëmendje të veçantë përfitimeve të mësimdhënies në klasë përballë mësimin në distancë, kundrejt **faktorëve të rrezikut që lidhen me rihapjen e shkollave**, duke marrë në konsideratë provat e paplota mbi rrezikun për infektimin lidhur me pjesëmarrjen në shkollë.

- Sa e domosdoshme është mësimdhënia në klasë për të arritur rezultatet përkatëse të të nxënësit (rezultate kryesore, të transferueshme, digjitale, specifike për punën), për të spikatur problematika si rëndësia e ndërveprimit të drejtpërdrejtë me mësuesit gjatë të nxënësit të bazuar në lojë me fëmijët në moshë të vogël dhe për zhvillimin e aftësive kryesore?
- A është i mundur dhe i aksesueshëm mësimi cilësor në distancë (për rezultatet përkatëse të të nxënësit, grupmoshat dhe grupet e marginalizuara)?
- Sa gjatë mund të përballohet qasja aktuale e mësimin në distancë, duke përfshirë dhe arritjet e të nxënësit, si dhe mirëqenien sociale dhe emocionale, duke pasur parasysh presionin që po i ushtrohet kujdestarëve në shtëpi dhe faktorët e tjerë specifike për kontekstin?
- A janë kujdestarët të pajisur me mjetet e nevojshme për të mbrojtur fëmijët nga ngacmimi dhe dhuna me bazë gjinore në internet teksa ata mësojnë nëpërmjet platformave online?
- Si ndikohen elementet kyçe të tranzicionit në përvojën e të nxënësit (gatishmëria për shkollë; përfundimi i arsimit 9-vjeçar dhe kalimi në ciklin pasardhës; përfundimi i arsimit të mesëm dhe kalimi në atë universitar) nga pandemia dhe nga reagimet që janë ndërmarrë ndaj saj?
- Sa të përgatitur dhe të aftë janë mësuesit dhe autoritetet arsimore për t'u përshtatur me qasjet e ndryshme administrative dhe mësimore? A janë ata të përgatitur dhe të aftë për të zbatuar masat parandaluese dhe kontrolluese të infektimit?
- A ekzistojnë rreziqe ndaj mbrojtjes, për sa i përket fëmijëve që nuk ndjekin shkollën, të tilla si rritja e rrezikut për dhunë në familje apo shfrytëzimi seksual i vajzave dhe djemve?
- A kompromenton mbyllja e shkollave shërbime të tjera të mbështetjes që ofrohen nga shkollat, të tilla si veprimtaritë shëndetësore dhe të ushqyerjes në shkollë?
- Cilët janë ndikimet sociale, ekonomike dhe ato që lidhen me mirëqenien e fëmijëve të cilët nuk ndjekin shkollën?



- Cili është kapaciteti i shkollës për të lehtësuar rreziqet lidhur me ndjekjen e procesit të rregullt mësimor në shkollë, të tilla si distancimi social (për shembull përmasat e klasave në raport me numrin e nxënësve); dhe strukturat për furnizim me ujë dhe kanalizimet, si edhe praktikave të higjienës?
- Cili është niveli i ekspozimit ndërmjet popullatës shkollë dhe grupeve me rrezik të lartë, si të moshuarit dhe personat me probleme shëndetësore? Nëse niveli i ekspozimit është i lartë, a mund të ndërmerren masa të mjaftueshme zbutëse?
- Me çfarë udhëton popullata shkollë për të shkuar në shkollë dhe për t'u kthyer në shtëpi?
- Cilët janë faktorët e rrezikut që lidhen me komunitetin duke marrë në konsideratë faktorët epidemiologjikë, kapacitetet e shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor, dendësinë e popullsisë dhe zbatimin e distancimit social dhe praktikave të mira të higjienës?




Analizimi i përfitimeve dhe rreziqeve specifike për kontekstin bën të mundur prioritizimin e rihapjes së shkollave (ose komponentëve të shkollave); prioritizimin e masave zbutëse të rrezikut në shkolla dhe komunitete; dhe prioritizimin e fushave që kërkojnë vëmendje lidhur me mësimin në distancë.

Si duhet të rihapen shkollat?

Kur vendoset që shkolla të caktuara të rihapen, duhet të përdoren gjashtë kriteret kyçe për të vlerësuar gjendjen e tyre të gatishmërisë dhe për të ndihmuar me planifikimin: politikat, financimi, funksionimi i sigurt, të nxëniet, arritja deri te fëmijët më të marginalizuar dhe mirëqenia/mbrojtja. Konsideratat lidhur me politikën dhe kërkesat financiare, bashkërisht krijojnë hapësirën e nevojshme për mbështetjen e dimensioneve të tjera.

Kontekstualizimi dhe përshtatja do të jenë parësore për t'iu përgjigjur nevojave dhe kushteve vendase, veçanërisht për kontekstet ku ekzistojnë një sërë kufizimesh (si në rastin e zonave me popullsi të dendur, me kushte jo të mira të furnizimit me ujë, ato në konflikt, etj.). Analiza duhet të krahasojë kushtet para pandemisë, duke marrë në konsideratë kufizimet ekzistuese në kontekstet me burime të pakta, gjithashtu dhe synimet aktuale.



për të përmirësuar kushtet funksionale dhe ato të të nxëniet. Përgjigja duhet të shërbejë si nxitës për përmirësimin e rezultateve të të nxëniet, për përmirësimin e aksesit të barabartë në arsim dhe për përmirësimin e mbrojtjes, shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve.

	Përpara rihapjes	Pjesë e procesit të rihapjes	Shkollat e rihapura
	Përgatitja e politikave, procedurave dhe planit kryesor të financimit që nevojiten për përmirësimin e të mësuarit, duke i kushtuar vëmendje funksionimit të sigurt, duke përfshirë përmirësimin e praktikave të mësimit në distancë.	Ndihni qasje proaktive për të integruar sërish fëmijët e marginalizuar dhe ata që nuk ndjekin shkollën. Investoni në furnizimin me ujë, kanalizimet dhe higjienën për të zburuar rreziqet dhe përqendrohuni në arsimin kompensues për të plotësuar kohën mësimore të humbur.	Monitoroni në mënyrë aktive treguesit shëndetësorë, duke i kushtuar vëmendje mirëqenies dhe mbrojtjes. Përmirësoni pedagogjinë, përshtatni arsimin në distancë, për të kombinuar mësimdhënien me të nxëniet, duke përfshirë njohuritë mbi përhapjen dhe parandalimin e infektimit.
Funksionimi i sigurt [Për këshilla të detajuara, shihni Udhëzuesin e IASC (Komiteti i Përhershëm Ndërragjencor) për Parandalimin dhe Kontrollin e COVID-19 në Shkollë.]	Jepni udhëzime të qarta kombëtare mbi parametrat e vendimmarrjes lidhur me hapjen e shkollave. Ato duhet të jenë progresive, duke filluar në zonat me numrin më të ulët të përhapjes dhe me rrezikun më të ulët të lokalizuar.	Autoritetet arsimore duhet të përmirësojnë mekanizmat e komunikimit dhe koordinimit që promovojnë dialogun vendor dhe angazhojnë në çështjet e arsimit komunitet, prindërit dhe fëmijët.	Hartoni një model vendimi për rimbylljen dhe rihapjen e shkollave, sipas nevojës në rast të shtimit të përhapjes së infeksionit në komunitet.
	Hapja e shkollave gjithashtu mund të kryhet në faza, për shembull, fillimisht mund të hapen vetëm në ditë të caktuara të javës, për klasa ose nivele të caktuara. Politikën kombëtare duhet të parashikojnë udhëzime të qarta për vlerësimin dhe vendimmarrjen në nivel lokal.	Rrisni numrin e shkollave që kanë furnizim të sigurt me ujë, me hapësira për larjen e duarve, furnizime me produkte pastrimi dhe, nëse është e mundur, krijoni ose përcaktoni tualete ose nevojtoare të ndara sipas seksit, duke përfshirë dhe ofrimin e produkteve për higjienën menstruale.	Vendosni theksin te ndryshimi i sjelljeve për të shtuar intensitetin dhe shpeshtësinë e veprimtarive të pastrimit dhe dezinfektimit, si dhe për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të mbetjeve.
	Hartoni protokolle të detajuara mbi masat e higjienës, duke përfshirë larjen e duarve, rregullat e frymëmarrjes, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, procedurën e pastrimit për hapësirat dhe praktikën e përgatitjes së sigurt të ushqimit.	Udhëzoni drejtuesit e shkollave lidhur me përcaktimin e procedurave nëse një nxënës ose pjesëtar i stafit sëmurë. Udhëzimi duhet të përfshijë monitorimin e shëndetit të nxënësit dhe pjesëtarit të stafit, duke qenë në kontakt të rregullt me autoritetet vendore të shëndetësisë, dhe duke përditësuar planin e emergjencës dhe listat e kontaktit.	
	Shqyrtoni politikën e personelit dhe frekuentimit së bashku me shoqatat e mësuesve për të marrë në konsideratë mungesat për arsye shëndetësore dhe për të mbështetur mësimdhënien në distancë dhe të kombinuar.	Gjithashtu, shkollat duhet të sigurohen që të kenë hapësira të caktuara për veçimin e përkohshëm të nxënësve dhe pjesëtarëve të stafit që janë të sëmurë pa i stigmatizuar. Njoftojeni stafin, prindërit dhe nxënësit mbi procedurën, duke përfshirë këshillimin e të gjithë nxënësve dhe pjesëtarëve të stafit që janë të sëmurë që të qëndrojnë në shtëpi.	

Përpara rihapjes

Pjesë e procesit të rihapjes

Shkollat e rihapura

Përqendrimi te të nxënët	<p>Shqyrtoni financimin lidhur me reagimin dhe rikuperimin për investime të menjëhershme në furnizimin me ujë, kanalizimet dhe higjienën në shkollë. Jepini përparësi kostove të produkteve dhe shërbimeve për pastrimin dhe dezinfektimin e plotë të shkollave dhe për planet e kontigjencës dhe rezervat.</p>	<p>Promovoni praktikat e higjienës në të gjitha nivelet dhe për të gjithë stafin e sistemit të shkollës, duke theksuar larjen e duarve dhe rregullat e frymëmarrjes.</p>	<p>Nxisni përdorimin e higjienizuesve për duart, dhe në rastin kur rekomandohet nga autoritetet kombëtare, theksoni rëndësinë e përdorimit të duhur të maskave prej rrobe. Informacioni mbi higjienën duhet të jetë lehtësisht i disponueshëm dhe i aksesueshëm, duke përfshirë dhe disponueshmërinë në gjuhët minoritare ose braille, dhe në gjuhë të lehtë për t'u kuptuar nga fëmijët.</p>
	<p>Përdorni reagimin ndaj COVID-19 si një mundësi për të shqyrtuar politikat mbi përdorimin e hapësirave shkollore gjatë emergjencave (si strehat, hapësirat shëndetësore, vendet e karantinës, etj.)</p>		
	<p>Ofroni mesazhet dhe drejtuesve të shkollave mbështetje dhe trajnim mbi mësimin në distancë dhe mënyrat se si ata mund të ndihmojnë nxënësit e tyre gjatë kohës që shkollat janë të mbyllura. Këtu mund të përfshihet edhe krijimi i grupeve të nxënësve në platformat telefonike ose mundësi i kontaktit me prindërit.</p>	<p>Rishikoni politikat dhe kërkesat e pranimit në mënyrë që të përshtaten me qëllimet e arsimit universal, duke eliminuar barrierat dhe duke reduktuar kërkesat e pranimit në shkollë.</p> <p>Krijoni ose përditësoni standardet e ekuivalencës dhe njohjes zyrtare të mënyrave alternative të të nxënët.</p>	<p>Shtoni investimet për mësimin në distancë (1) për t'u përgatitur për raste të mbylljes së shkollës në të ardhmen, (2) për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënët në rastet kur mbyllja e shkollave vazhdon dhe (3) për të plotësuar orët mësimore sipas një model të kombinuar kur shkollat funksionojnë me orare të pjesshme ose të përshtatura.</p> <p>Përfshini shtimin e financimit për përmirësimin e kapaciteteve dhe trajnimit të mësuesve.</p>
	<p>Krijoni kalendare akademike alternative bazuar në skenarë të ndryshëm të shëndetit publik, duke marrë në konsideratë modalitetet që do të përdoren për mësimin në distancë.</p>	<p>Përgatisni mësuesit për të adresuar kompensimin e të nxënët, si dhe për të përmbyshur nevojat psikosociale të nxënësve dhe ato të shëndetit mendor (ShMMP). Përpjekjet e trajnimit duhet të përmirësojnë konkretisht aftësinë e mësuesve për të përmbyshur nevojat bazë të nxënësve për sa i përket shprehive për të shkruar e lexuar/shprehive të aritmetikës dhe nevojat sociale dhe emocionale, veçanërisht në shkollat me një përqindje të lartë të nxënësve të rrezikuar.</p> <p>Mësuesit duhet të trajnohen për të identifikuar sjelljet si dhe ndryshimet në aspektin njohës që përkojnë me moshën dhe të ofrojnë mbështetjen e përshtatshme për të nxënët.</p>	<p>Merrni në konsideratë anulimin e testeve që nuk janë me rëndësi, si ato që përdoren për ngritjen në detyrë, me qëllim përqendrimin e burimeve për të siguruar që testimet me rëndësi të madhe (si ato për përfundimin e arsimit të mesëm dhe pranimit në universitete) të kryhen siç duhet, në mënyrë të besueshme dhe të barabartë, duke zbatuar distancimin fizik dhe kërkesat e tjera shëndetësore.</p> <p>Merrni në konsideratë promovimin universal kurdo që është e mundur dhe vlerësoni nivelet e të nxënët të nxënësve pas mbylljes së shkollave, në mënyrë që të mund të përcaktoni përpjekjet kompensuese.</p>
	<p>Vlerësoni ndikimin në sektorin e arsimit privat dhe merrni në konsideratë reagimet e mundshme, duke përfshirë zgjerimin e ofrimit publik dhe financimin publik për sektorin privat dhe reagime të tjera të përshtatshme.</p>	<p>Zbatoni gjerësisht programe kompensuese për të kompensuar humbjet në të nxënë dhe për të parandaluar thellimin e pabarazisë së të nxënët pas mbylljes së shkollave, duke u përqendruar në shprehite e të shkruarit, të lexuarit dhe aritmetike të fëmijëve në shkollë fillore dhe aksesueshmërinë e komoditeteve për fëmijët me aftësi të kufizuara.</p> <p>Modelet e përshtatshme arsimore mund të zbatohen paralelisht për të integruar fëmijët që nuk ndjekin shkollën ose ata në moshë më të madhe të shokët e klasës.</p>	<p>Zbatoni metoda novatore të mbështetjes së mësuesve, të tilla si zhvillimi profesional online, trajnimi, ose angazhimi i mentorëve për të ndihmuar në përmirësimin e shpejtë të përpjekjeve për zhvillimin e kapaciteteve. Ky trajnim dhe përmirësim i aftësive mund të integrohet edhe në trajnimet formale para dhe gjatë ushtrimit të detyrës së mësuesit.</p>
Mirëqenia dhe mbrojtja	<p>Siguroni kalimin në kohë dhe të vazhdueshme të pagave të mësuesve, duke u kushtuar vëmendje atyre që janë me kontrata të përkohshme, për të shmangur presionin ndaj mësuesve dhe për të promovuar mirëqenien.</p>	<p>Shtoni numrin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe mbështetjes psikosociale që adresojnë stigmatizimin/diskriminimin dhe mbështesin fëmijët dhe familjet e tyre për të përballuar pasiguritë e vazhdueshme nga pandemia.</p>	<p>Ofroni informacion të qartë, konciz dhe të saktë mbi COVID-19, neutralizoni mesazhet rreth frikës dhe ankthit dhe promovoni strategji të përkujdesjes ndaj vetes jo vetëm për nxënësit e familjet e tyre, po dhe për mësuesit dhe pjesëtarë të tjerë të stafit shkollore.</p>
	<p>Siguroni kalimin në kohë dhe të vazhdueshme të pagave të mësuesve, duke u kushtuar vëmendje atyre që janë me kontrata të përkohshme, për të shmangur presionin ndaj mësuesve dhe për të promovuar mirëqenien.</p>	<p>Kryeni një vlerësim të rrezikut për mësuesit dhe pjesëtarë të tjerë të stafit (duke marrë në konsideratë moshën, sëmundjet kronike dhe faktorë të tjerë të rrezikut), më pas zbatoni një qasje të strukturuar për rikthimin në shkollë.</p>	<p>Shqyrtoni dhe përmirësoni sistemet e referimit, veçanërisht për rastet serioze. Sigurohuni që të gjithë ofruesit të jenë në dijeni të shërbimeve të tjera të përkujdesjes, duke përfshirë shërbimet e referimit për DhBGj/PSEA dhe shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR).</p>

	Riaktivizoni ofrimin e rregullt dhe të sigurt të shërbimeve kryesore. Këto shërbime përfshijnë, por jo vetëm, ushqyerjen jetike, shërbimet WASH (uji, pastrimi, higjiena) dhe shëndetësore si ushqyerja në shkollë, fushatat e vaksinimit, referimi mbrojtës (ShMMP, dhuna me bazë gjinore, abuzimi, etj.) dhe shërbimet e specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara.	Në rastet kur shërbimet nuk ofrohen në shkollë, përmirësoni sistemet e referimit, duke përfshirë ato për ShSR, që të jenë të përshtatshme për të rinjtë dhe plotësisht të aksesueshme.
--	--	--

	Përpara rihapjes	Pjesë e procesit të rihapjes	Shkollat e rihapura
Arrija te personat më të	Përqendrojeni financimin për arsimin te shkollat që janë më të prekura nga kriza, për shembull nëpërmjet financimit të bazuar në formulën që u jep përparësi fëmijëve më të marginalizuar. Për sa u përket mekanizmave, merrni në konsideratë grantet fikse dhe transfertat në para (të kushtëzuara ose të pakushtëzuara) për nxënësit.	Hiqni tarifat shkollore dhe kostot e tjera (uniformat e shkollës etj.) nëse është e mundur, dhe eliminoni kushtëzimet e tjera ndaj pranimit në shkollë, me qëllim maksimizimin e numrit të rikthimit në shkollë.	Jepini përparësi financimit për mbështetjen e nevojave të reja të rikuperimit, veçanërisht për nxënësit e disavantazuar. Një qasje e mundshme është pezullimi ose shqyrtimi i përkohshëm i elementeve të bazuar në performancë të financimit për frymë, që mund të sigurojë financim të vazhdueshëm dhe të parandalojë reduktimet për shkak të mungesës së aritjeve ose pajtueshmërisë.
	Përshtatni politikat dhe praktikat e hapjes së shkollave për t'iu mundësuar aksesin edhe grupeve të marginalizuara, si fëmijët që më parë nuk ndiqnin shkollën, fëmijët e shpërngulur/migrantë dhe minoritetet. Diversifikoni komunikimet dhe njoftimet kryesore duke i bërë të disponueshme në disa gjuhë, në formate të aksesueshme dhe duke i përshtatur për popullatat përkatëse. Merrni masa specifike për të lehtësuar kërcënimet ndaj mbrojtjes gjatë kohës që vajzat dhe grupet e tjera të marginalizuara nuk janë në shkollë nëpërmjet rritjes së angazhimit komunitar dhe përmirësimit të referimeve.	Merrni masa specifike për të mbështetur rikthimin e vajzave në shkollë nëpërmjet rritjes së angazhimit komunitar.	Sigurohuni që materialet/platformat mësimore, informacionet, shërbimet dhe mjediset janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Informacioni dhe komunikimet lidhur me shëndetin publik duhet të jenë të disponueshme në formate të shumta dhe të aksesueshme, duke përfshirë dhe formate për personat me dëmtime të dëgjimit ose shikimit. Duhet të bëhen ndryshime për të siguruar që shërbimet e furnizimit me ujë, të higjienës dhe kanalizimit të jenë të aksesueshme. Planifikoni për vijueshmërinë e shërbimeve ndihmëse, nëse shkollat mbyllën sërish.

Udhëzime të tjera me rëndësi

Për të mbështetur këtë kornizë janë të disponueshëm ose në zhvillim një sërë burimesh dhe mjetes plotësuese. Kjo listë do të përditësohet rregullisht.

WFP, FAO, UNICEF, Mitigating the effects of the COVID-19 pandemic on food and nutrition of schoolchildren [Lehtësimi i efekteve të pandemisë COVID-19 në ushqimin dhe ushqyerjen e fëmijëve në moshë shkolle] <https://www.wfp.org/publications/mitigating-effects-covid-19-pandemic-food-and-nutrition-schoolchildren>

UNESCO, COVID 19 Education Response – Education Issue Note N° 7.1 [COVID 19 Reagimi në Arsime - Botim shënimi arsimor Nr. 7.1]– Prill 2020 <https://en.unesco.org/covid19/educationresponse>

UN Special Rapporteur on the right to adequate housing, COVID-19 Guidance Note Protecting Residents of Informal Settlements [Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën për strehim të përshtatshëm, Udhëzues mbi COVID-19 për Mbrojtjen e Banorëve të Banesave Joformale] https://unhabitat.org/sites/default/files/2020/04/guidance_note_-_informal_settlements_29march_2020_final3.pdf

World Bank resources on education during COVID-19 [Burimet e Bankës Botërore për arsimin gjatë COVID-19] adresa: <https://www.worldbank.org/en/data/interactive/2020/03/24/world-bank-education-and-covid-19>

Referencat

IASC, "Guidance on COVID-19 Prevention and Control in Schools" [IASC, Udhëzues për Parandalimin dhe Kontrollin e COVID-19 në Shkollë] <https://www.unicef.org/reports/key-messages-and-actions-coronavirus-disease-covid-19-prevention-and-control-schools>

Kombet e Bashkuara, Dokument politikash: "The Impact of COVID-19 on children" 15 APRIL 2020 [Ndikimi i COVID-19 te fëmijët 15 PRILL 2020] https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/policy_brief_on_covid_impact_on_children_16_april_2020.pdf

World Bank, "We should avoid flattening the curve in education – Possible scenarios for learning loss during the school lockdowns", [Banka Botërore, Ne duhet të shmangim sheshimin e kurbës në arsim - Skenarë të mundshëm për humbjet në të nxënë gjatë mbylljes së shkollave] https://blogs.worldbank.org/education/we-should-avoid-flattening-curve-education-possible-scenarios-learning-loss-during-school?CID=WBW_AL_BlogNotification_EN_EXT

Banka Botërore, "The COVID-10 Pandemic: Shocks to Education and Responses", Draft Paper [, Pandemia COVID-10: Tronditjet në Arsime dhe Reagimet, Projekt dokument]

Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Considerations in adjusting public health and social measures in the context of COVID-19" Interim guidance 16 April 2020 [, Konsiderata për përshtatjen e masave të shëndetit publik dhe ato sociale në kontekstin e COVID-19, Udhëzues i ndërmjetëm, 16 prill 2020] https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/331773/WHO-2019-nCoV-Adjusting_PH_measures-2020.1-eng.pdf

Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Non-pharmaceutical public health measures for mitigating the risk and impact of epidemic and pandemic influenza" [Masat jofarmaceutike të shëndetit publik për zbutjen e rrezikut dhe ndikimit të gripit epidemik dhe pandemik] (2019) https://www.who.int/influenza/publications/public_health_measures/publication/en/

Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Reducing transmission of pandemic (H1N1) 2009 in school settings" [Reduktimi i përhapjes së pandemisë (H1N1) 2009 në kushtet shkollore] https://www.who.int/csr/resources/publications/reducing_transmission_h1n1_2009.pdf